



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
**Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of**  
**Freelance Professions**

**Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee**

**DPL.nr.09/2022**

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, , si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 06/2022, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, për palën ankuese nga sipas autorizimit ,avokat nga në mungesë të përmbarduesit privat, i ftuar me rregull për seancë, me datë 20.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Organi përmbardues - Përmbarduesi Privat, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,000.00 euro (**njëmijë**), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Pala ankuese me datë 11.03.2022, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbardimin Privat ndaj përmbarduesit privat, pranë të cilës ka mbetur në seancën dëgjimore edhe përfaqësuesi me autorizim i palës ankuese.

Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat, me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr 06/2022, ka kryer shkelje të dispozitave të LPP-së, duke zbatuar e tejkaluar autorizimet e tij të përcaktuara me ligj. Kjo nga shkakun se përmbaruesi ia ka mbyllur llogarinë private palës ankuese për një kredi që ka pasë të bëjë me biznesin e tij, dhe iu është bllokuar automjeti i tij, i cili automjeti nuk ishte i lënë peng sipas marrëveshjes mbi pengun. I ka propozuar komisionit që të shqiptohet masa disiplinore.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Notarinë dhe Përmbarimin Privat, me datën 24.03.2022, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore P. nr 06/2022.

Përmbaruesi privat, në përgjigjen e tij me shkrim ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën e palës ankuese si të pabazë, sepse sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, dhe në kuadër të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), lejohet që nëse pala bëhet insolvent-borxhli, përgjigjet edhe me asetet e tij personale, pasi që LPP-ja, i trajton të gjithë debitorët njëjtë. I ka propozuar Komisionit Disiplinor që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, ka ardhë në përfundim se përmbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesi privat në këtë rast ka tejkaluar autorizimet e tij me rastin e bllokimit të llogarisë private të palës ankuese, përderisa llogaria e biznesit dhe biznesi i tij ishin aktive dhe pa të drejtë përmbaruesi privat e bllokoi llogarinë bankare të palës ankuese. Poashtu komisioni disiplinor vlerëson se përmbaruesi privat, e ka tejkaluar autorizimin e tij të besuar me ligj edhe me rastin e bllokimit të automjetit për regjistrim të palës ankuese, sepse automjeti në fjalë nuk ishte i lënë peng në Marrëveshjen mbi Pengun me numër 1883/14 GJA e datës, 19.09.2011. Për këto arsye, komisioni vlerëson se përmbaruesi privat në këtë rast ka rënë ndesh me dispozitën ligjore të nenit 367, paragrafi 1, nënparagrafi 1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin se pala ankuese nuk kishte pësuar ndonjë dëm të madh të prezantuar para komisionit, i cili do të ndikonte në lartësinë e masës së shqiptuar.

Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368, paragrafi 1, nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbaruesin privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimi se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 368 paragrafi 3 të LPP-së, në të cilën përcaktohet se gjobat në të holla paguhet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
**DPL.nr 09/2022 datë 20.05.2022**

**Kryesuese e Komisionit Disiplinor**  
**Manushë Karaçi**



***KËSHILLË JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.